



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
KRYETARI

Nr. 1145 prot.

Tiranë, më 24 . 12 . 2025

URDHËR

Nr. 297, datë 24.12.2025

“Për pezullimin e afateve gjatë periudhës së lejes vjetore”

Bazuar në nenin C, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 13, germa “c”, nenin 14, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 18, pika 1, germa “b” të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 7, pika 1 të Rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, për shkak të lejes vjetore të gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Pezullimin e afatit të zbardhjes së vendimeve sipas nenit 24, pika 1 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, për periudhën nga data 29.12.2025 deri më 12.01.2026¹, për çështjet e përfunduara në kuadër të Juridiksionit të Rivlerësimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.
2. Pezullimin e afatit të shqyrtimit paraprak të kërkesave në kuadër të Juridiksionit Disiplinor, sipas nenit 21 të rregullores “Për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese”, për periudhën nga data 29.12.2025 deri më 12.01.2026².
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
4. Një kopje e këtij urdhri t’i komunikohet Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e web-it të Kolegjit.

KRYETARI



Sokol Çomo

¹ Data 12.01.2026 nuk përfshihet në afatet e pezullimit.

² Data 12.01.2026 nuk përfshihet në afatet e pezullimit.